



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:161586

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05724293

Ac.nr.8274/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Nora Bllaca Dula e Halide Reka, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L. H nga Gjakova, të cilin e përfaqëson Y. B avokat në Gjakovë, kundër të paditurës K..., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson G. J, për kompensimin e tri pagave jubilarë, duke vendosur lidhur ankesën e paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.4965/2019 të datës 05.05.2022, me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit L. H nga Gjakova, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.4965/2019 i datës 05.05.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit refuzohet në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit L. H nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura K... sh.a, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar, t'ia paguaj tri paga mujore, në shumën prej 2,550.00€, si dhe në emër të dy pagave përcjellëse, shumën 1,700.00€, e në total shumën 4,250.00€, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në pikën II., të dispozitivit secila nga palët i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësi për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të të drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi ankimor, duke aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, apo të

prishet aktgjykimi ankimor dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi L. H ka parashtruar padi kundër të paditurës K..., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpërblimit jubilar, t'ia paguaj tri paga mujore, në shumën prej 2,550.00€, si dhe në emër të dy pagave përcjellëse, shumën 1,700.00€, e në total shumën 4,250.00€, me kamatë ligjore prej 8%.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat dhe atë: kartela e punëtorit e lëshuar nga e paditura për paditësin, kartela e punëtorit e lëshuar nga K... sh.a për paditësin, kontrata e punës e lidhur në mes ndërgjyqësve me nr.9901/9615 e datës 08.05.2016, si dhe përshkrimi i detyrave të punës sipas kësaj kontrate, vendimi i të paditurës nr.689 i datës 24.08.2018, qarkullimi në llogarinë bankare të paditësit për periudhën 01.01.2018 deri me datë 17.07.2019 dhe dëshmia e të paditurës për pagesën e një page përcjellëse në muajin shkurt të vitit 2018.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike: se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura dhe i njëjti ka arritur që pas rreth 35 viteve të përvojës së punës, ka dal në pension me datë 05.02.2018.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji gjen se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike dhe aplikimin e të drejtës materiale, Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se, gjykata e shkallës së parë me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, ka marr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Këtë vlerësim të gjykatës së shkallës së parë, në tërësi e mbështet edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë dhe vlerëson se, në rastin konkret bëhet fjalë lidhur me arritjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e pagave jubilarë. Kjo për faktin se paditësi është pensionuar më datën 05.02.2018. Në kohën e pensionimit paditësi ka arritur përvojën e punës prej 35 viteve. Në nenin 52 par 1,2 dhe 3 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (MPKK), në lidhje me të drejtën në kompensim të pagave jubilarë, parashihet me sa vijon: *1. I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1. për 10 vjet të përvojës në punë të pandërprerë, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2. për 20 vjet të përvojës së punës së pa ndërprerë, në vlerë të dy pagave mujore të tij; 1.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë prej tri pagave mujore të tij. 2. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimet jubilarë.*

Kolegji ka gjetur se MPKK nuk ofron mbulesë ligjore për shpërblimin jubilar për përvojën e arritur mbi 30 vite. Shikuar nga koha e daljes në pension kur paditësi kishte arritur përvojën e punës prej 35 viteve, kolegji ka ardhur në përfundim se paditësi vitin e fundit jubilar prej 30 vitesh e ka arritur me 05.02.2013. Meqenëse MPKK ka pasur shtrirje kohore nga data 01.01.2015 – 31.12.20017, Kolegji i Gjykatës së Apelit ka gjetur se, kërkesa e paditësit nuk gjen mbulueshmëri ligjore sipas MPKK-së, pasi e njëjta nuk mundet që të ketë efekt prapa veprues pas skadencës së fuqisë së saj sipas ligjit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8274/2022 me datë 22.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj